REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2022:067547
Datë: 28.07.2022
Numri i dokumentit: 03276545

P.nr.2022:074243

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm - Gjyqtarja e vetme gjykuese Hakile Ilazi, me Praktikantin e kësaj gjykata Ari Shahini, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.M, për shkak se ka kryer veprën penale "Rrezikim i trafikut publik" nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 të KPRK-së, sipas aktakuzës: PP/II.nr.434/22 të datës 22.06.2022 të Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar – publik të mbajtur me datë 15.07.2022 në praninë e Prokurorit së Shtetit Albana Parduzi të akuzuarit A.M me datë 15.07.2022 kumtoi vendimin, kurse me datë 20.07.2022 përpiloi me shkrim këtë:

A K T GJ Y K I M

I akuzuari **A.M,** nga i ati B. dhe e ëma H., e gjinisë A., i lindur me datën .... në Prishtinë, me vendbanim në rrugën "...." në Ferizaj, ka te kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i dy(2) femijeve, i gjendjes së mesme ekonomike, me profesioni gjamëprerës, ka te kryer fakultetin e Kriminalistikës shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal ....

ËSHTË FAJTOR

më dt.23.02.2022, rreth orës 23:00, në rrugën "..." në Ferizaj, duke drejtuar automjetin të markës "....", ngjyrë hiri, me targa ...., ka vepruar në kundërshtim me nenin 53.1 të Ligjit mbi Rregullat e Trafikut Rrugor nga pakujdesia ka rrezikuar trafikun publik dhe jetën e njerëzve, në atë mënyrë që nuk ka



2022:128467

përshtatur shpejtësinë e lëvizjes dhe kushteve të rrugës, ashtu që humb kontrollin mbi automjet dhe kalon në shiritin e kundër qarkullues dhe me pjesën e përparme të anës së djathtë e godet automjetin "..", ngjyrë e kuqe, me targa ...., e cila lëvizte në drejtim të kundërt të cilën e drejtonte tani i dëmtuari E.Hi, me ç' rast **lëndime të rënda trupore** ka pësuar i dëmtuari E.H, ndërsa lëndime të lehta trupore ka pësuar pasagjeri M.R, të përshkruara si në akt-ekspertimin mjeko-ligjor të dt. 16.06.2022,-

**- me të cilën ka kryer veprën penale "Rrezikim i trafikut publik" nga nen.370 par. 8 lidhur me par.6 të KPRK-së.**

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 46, 47, 48, 49, si dhe në bazë të neneve 359 dhe 365 të KPPRK-së, të akuzuarit i:

GJ Y K O N

D E N I M M E KUSHT

Të pandehurit A.M i cakton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajsh i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën kohore prej 1 (një) vite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

Udhezohet i dëmtuari E.H me vendbanim "...."qe kerkesen pasurore juridike ta realizoj ne kontest të rregullt civil.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20€ (njëzetë euro) për shpenzimet e procedurës penale 170/njëqind e shtatëdhjetë euro/ për /ekspertizën mjeko ligjore dhe ekspertizën e komunikacionit/ si dhe konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 30€ (tridhjetë euro) brenda afatit prej 30/tridhjetë/ ditëve nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi

**A r s y e t i m i**



2022:128467

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.434/22 të datës 22,06,2022, ka ngarkuar të akuzuarin A.M me të cilën ka kryer veprën penale“Rreyikim i trafikut publik ” nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 të KPRK-së, duke propozuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe t’i shqiptohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale ku caktoi seancën fillestare me date 15.07.2022 ku ishte prezent i akuzuari dhe përfaqësuesi i akuzës-prokuroria e shtetit, e cilia e lexoj aktin akuzues, dhe gjyqtarja pasi që u bind se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, konform nenit 246 par. 4 dhe përkundër paralajmërimit për nenet 325 dhe 323 të KPPK-së, të pandehurit i ofroj mundësinë të pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

I akuzuari A.M ne shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila iu vihet në barrë sipas të gjitha pikave te saj, duke shprehur keqardhje dhe është penduar thellë. Duke shtuar se i premton gjyktës që nuk do të kryej vepra të tilla penale, e lut gjykatën që të më shqiptoj një dënim sa më të butë , sepse jam mbajtës i familjes.

Prokurori i Shtetit nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga te pandehurit me qene se një pranim i tille është bere konforme dispozitave ligjore te nenit 248 te KPPK-se, pra ne mënyre vullnetare nga i cili ka mbështetje ne te gjithat provat dhe shkresat qe përmban aktakuza, i propozoj gjykatës qe ta këtë parasysh pranimin e fajësisë, dhe ti dënoj sipas ligjit me një dënim qe do te arrihet qëllimi i dënimit.

I dëmtuari E.H lidhur me ndjekjen penale dhe paraqitjen e kërkesës pasurore juridike deklaron se nuk i bashkëngjitëm ndjekjes penale, ndërsa sa i përket kërkesës pasurore juridike jam ne procedure me kompaninë e sigurimeve po ashtu thekson se i akuzuari A.M është kujdesur për gjendjen time shëndetësore, ka ardhur ne vizite ne spitalin tek qendra klinike universitare ne Prishtine

Me që i pandehuri ka pranuar fajësinë gjyqtarja e vetëm gjykuese ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 KPPK-së i pandehuri i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajit mbështetët në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e



2022:128467

prezantuara nga prokurori i shtetit dhe në provat tjera të cilat gjinden në shkresat e lëndës siç janë:

- raporti i policit hetues i dt. 23.02.2022,
- raporti mjekësor nga Qendra Emergjente në Ferizaj i dt 23.02.2022,
- Raporti Specialistik ortopedik -poliklinika mjekësore "Z.." e datës 24.02.2022,
- QKMF-Kabineti i radiologjisë -Konstatimi Radiologjik i datës 18.03.2022,
- Poliklinika Pulsi-Raport specialistik i datës 16.03.2022,
- Ordinanca Specialistike "O...." i datës 15.03.2022,
- Ordinanca Specialistike "O....." i datës 23.03.2022,
- QKUK-ë Klinika e ortopedisë me traumatologjinë lokomotorë Prishtinë –Fletëlëshim i datës 24.02.2022-11.03.2022,
- deklarata e të pandehurit të A.M të dhënë në polici e dt 26.02.2022,
- deklarata e të dëmtuarit E.H të dhënë në polici e dt 22.03.2022,
- akt ekspertimi i ekspertit të mjekësisë-ligjore i dt. 16.06.2022 i dr. Bergita Curri,
- konstatimi dhe mendimi i ekspertit të komunikacionit i dt. 11.04.2022, i ekspertit Leonora Krasniqi Gashi ,
- si dhe shkresat tjera që gjenden në lëndë.

Me qenë se i akuzuari e ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjyqtarja konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale "Rrezikim i trafikut publik" nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 të KPRK-së, meqë me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi te pandehurit me veprimet e tyre në kundërshtim me dispozitat ligjore kane kryer veprën penale e cila ju vihet në barrë.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarit, Gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenit 70 dhe 71 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese



2022:128467

përkatësisht që në shqyrtimin fillestar i pandehuri ka pranuar fajësinë, rrethana lehtësuese pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, si dhe gjendjen e mesme të akuzuarit , mbajtës i familjes , , ndërsa në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese përveç që vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se i akuzuari në të gjitha fazat e procedurës penale ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-së përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryeseve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Vendimi lidhur me kerkesen pasurore Juridike- Kompensimin e pales se demtuar E.H është marr konform nenin 463 par.1 dhe par.2 të KPPK-së

Vendimi mbi shpenzimet paushallë është marr në kuptim të dispozitës së nenit 453 par. 1 lidhur me nenin 450 par.1 dhe 2 nen par. 2.6 të KPPRK-së.

Vendimi mbi kompensimin e viktimave te krimit është marre ne kuptim te nenit 39 par. pika 3.1 te ligjit, Nr.05/L-036, te Ligjit për Kompensimin e Viktimave te Krimit.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti Përgjithshëm-Divizioni Penal,



2022:128467

P.nr. 2022:128467 datë 20.07.2022

Procesmbajtesi Gjyqtarja vetme gjykuese

Ari Shahini Hakile Ilazi

**KËSHILLA JURIDIKE**: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit të Kosovës. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.